



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura V
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Punë të Jashtme

Mbledhja nr. 46

Prishtinë, më 18 janar 2017, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

P r o c e s v e r b a l

Në mbledhje morën pjesë: Elmi Reçica, Qerim Bajrami, Blerta Deliu-Kodra, Luljeta Veselaj-Gutaj, Ismet Beqiri, Puhie Demaku, Pal Lekaj dhe Zafir Berisha.

Mungoi: Teuta Rugova

Pjesëmarrës të tjerë: Lumnije Murati, ZRPK, Gurjeta Zeka, LVV, Eugen Cakolli, KDI, Blerta Bejtullahu, EUSR/EU Office dhe media.

Nga zyra e Komisionit: Minire Hasani dhe Manush Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Elmi Reçica, kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 12.12.2016 dhe dy procesverbale nga mbledhjet e mbajtura më 19.12.2016;
3. Miratimi i Raportit vjetor të punës së Komisionit;
4. Hartimi i Planit dhe Programit të punës së Komisionit për vitin 2017;
5. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes përkitazi me themelimin e Fondit të Ballkanit Perëndimor;
6. Diskutim në lidhje me kërkesën e deputetes znj. Puhie Demaku;
7. Informatë lidhur me organizimin e Samitit të kryetarëve të komisioneve të jashtme parlamentare;
8. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari konstatoi se Komisioni miratoi rendin e ditës.

Elmi Reçica - Sa i përket ndalimit të z. Haradinaj në Francë, është bërë një deklaratë në emër të komisionit dhe se i ka shkruar edhe homologes së tij në Francë që ta mbështesë Kosovën në këtë proces. Rreth çështjes së trenit Komisioni ka një qëndrim unik dhe pa dallime.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 12.12.2016 dhe dy procesverbale nga mbledhjet e mbajtura më 19.12.2016

Kryetari konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalin nga mbledhja e mbajtur në 12.12.2016 si dhe dy procesverbale nga mbledhjet e mbajtura më 19.12.2016.

3. Miratimi i Raportit vjetor të punës së Komisionit

Kryetari konstatoi se Komisioni miratoi Raportin vjetor të punës së Komisionit.

4. Hartimi i Planit dhe Programit të punës së Komisionit për vitin 2017

Elmi Reçica, tha se anëtarëve të Komisionit u është shpërndarë propozim-planit dhe programi i punës së Komisionit për vitin 2017 dhe propozoi që ai të diskutohet dhe miratohet në mbledhjen e radhës.

Kryetari konstatoi se Komisioni në mbledhjen e radhës do të diskutojë dhe miratojë Planin dhe programin e punës për vitin 2017.

5. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes përkitazi me themelimin e Fondit të Ballkanit Perëndimor

Elmi Reçica, njoftoi se Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes përkitazi me themelimin e Fondit të Ballkanit Perëndimor, Komisioni e ka shqyrtuar edhe më herët dhe se ky projektligj i është shpërndarë deputetëve më 15 dhjetor 2016. Më tej njoftoi se Komisioni është ngarkuar si Komision Funkcional që ta shqyrtojë këtë projektligj dhe t'ia paraqes Kuvendit raportin me rekomandime.

Për projektligjin, tha se përmban 3 nene dhe ka për qëllim të ratifikojë Marrëveshjen për themelimin e Fondit të Ballkanit Perëndimor, përmes së cilit promovohet zhvillimi i bashkëpunimit ndërmjet Palëve Kontraktuese, forcimi i lidhjeve, integrimi i palëve kontraktuese në BE dhe prezantimi i përbashkët në vendet e treta.

Puhie Demaku, tha se ky Projektligj është shqetësues për arsye se përmbajtja e marrëveshjes, e cila do të ratifikohet me miratimin e këtij projektligji, do ta shndërronte në një marrëveshje ndërkombëtare ku Kosova e pranon vetën me fusnotë. Fondi për Ballkanin Perëndimor, tha se është nismë e re që po krijohet dhe Kosova do të mund të përfaqësohet si republikë e plotë me sovranitet të plotë.

Znj. Demaku tha se në këto marrëveshje ku edhe Shqipëria ka rol kyç, do të ishte e mundur të ushtrohet trysni, e nëse Serbisë kjo nuk i pëlqen le të tërhiqet nga kjo marrëveshje dhe jo Kosova të mangësojë vetën. Ajo shprehu mendimin që të votohet kundër këtij projektligji për shkak se do të krijohej një precedent i dëmshëm.

Zafir Berisha, shprehu mendimin se nuk mund të procedohet ky projektligj ashtu siç është, sepse mosidentifikimi i shteti të Kosovës është pengesë dhe do të votojë kundër këtij projektligji. Ai më tej shtoi se fusnota e vendosur tregon varësinë ndaj një shteti, me të cilin kemi probleme dhe kjo fusnotë vjen si rezultat i bisedimeve shumë të dëmshme për Kosovën dhe që Kosovën e kanë bërë shtet jo funksional.

Blerta Deliu-Kodra, tha se është një marrëveshje e rëndësishme për faktin që po bëhet fjalë për një fond të Ballkanit Perëndimor, e që si qëllim bazë e ka edhe nxitjen e proceseve integruese të vendit. Znj. Deliu-Kodra tha se e ndanë shqetësimin me kolegët lidhur me fusnotën, megjithatë, tha se duhet të jemi të vëmendshëm karshi këtij procesi. Ajo tha se Kosova nuk duhet të përjashtohet nga një proces i rëndësishëm, por të shihet mundësia e fusnotës, e cila në disa raste edhe pse ka ekzistuar, ne kemi arritur që të jemi vizualisht në shumë shtete.

Sa i përket përjashtimi të Serbisë, Deliu tha se Serbia nuk do të përjashtohet nga një mekanizëm i tillë edhe nëse insistojmë, por duhet të rishikohet në seancë plenare se si do të votohet ratifikimi i një marrëveshje që e ka fusnotën.

Deliu-Kodra njoftoi se Kosova është pjesë e Asamblesë Parlamentare të Evropës Jug-Lindore si dhe e shumë mekanizmave tjerë rajonalë dhe se duhet të jemi të kujdesshëm se në çfarë forme do t'i qasemi pjesëmarrjes tonë në këtë fond

Pal Lekaj, tha se Kosovës i duhet integrimi në të gjitha institucionet, por i duhet një integrim si shtet dhe jo me fusnotë. Sa i përket projektligjit, tha se do të ishte mirë po të ishte prezent edhe ministri i Punëve të Jashtme dhe të bisedohej në detaje kjo marrëveshje, mirëpo kjo marrëveshje kështu siç është nuk i kontribuon forcimit të shtetit. Lekaj shprehu mendimin se edhe marrëveshjet e mëhershme kanë qenë të dëmshme për Kosovën dhe se dihen pasojat dhe synimet e tyre, sepse është vetëm Serbia që e kundërshton këtë. Në marrëveshje nuk ka parë se sa është ai fond dhe çka përfiton Kosova nga ky fond, përpos disa fonde të vogla në fushën e arsimit, shëndetësisë dhe kulturës. Ai shtoi se nuk duhet të biem në lajthitje, sepse Serbia ndoshta ka insistuar që Kosova të jetë pjesë e kësaj marrëveshje me qëllim që Kosova të mos njihet si shtet.

Ismet Beqiri, tha se vendosja e fusnotës në këtë rast nuk ka qenë vullnet yni, mirëpo, kjo nuk do të thotë se do të heqim dorë që të ngrisim zërin për këtë fusnotë. Sa i përket këtij projektligji, Beqiri tha se nuk po votohet për fusnotë, por për një projektligj që Kosovën e bën pjesë të një organizimi që ka të bëjë me Ballkanin Perëndimor.

Beqiri shprehu mendimin se do të ishte gabim nëse nuk përfitohet nga ky rast sepse prezenca jonë do të ishte një përfitim për Kosovën, dhe se refuzimi ynë nuk i ndihmon qëndrimin tonë që Serbia të largohet. Ai më tej shtoi se në organizime të ndryshme, ministrat e kanë lëshuar konferencën, por do të ishte gabim që ta përjashtojmë vetën dhe pse mos të detyrohet Serbia të largohet për shkak të prezencës së Kosovës.

Qerim Bajrami, njoftoi se Komisioni këtë marrëveshje e ka pasur në shqyrtim dhe e ka proceduar për Kuvend, mirëpo atje nuk ka pasur numër të mjaftueshëm për miratimin e këtij projektligji, për shkak të mungesës së 80 deputetëve që do të duhej të ishin të pranishëm.

Bajrami, tha se nuk e sheh të arsyeshme që tani ky projektligj të mos miratohet nga Komisioni dhe të procedohet për Kuvend. Lidhur me këtë marrëveshje, tha se sipas saj Kosova është anëtare e barabartë

me vendet e tjera, dhe se sipas saj vendoset me konsensus të vendeve anëtare, e po ashtu, theksoi se është e rëndësishme për ne që të jemi pjesëmarrës në të gjithë mekanizmat rajonalë.

Luljeta Veselaj-Gutaj, theksoi se sa i përket përfaqësimit të Kosovës me fusnotë, është shqetësim i të gjithëve, mirëpo marrëveshje dhe projektligjet e tilla janë të rëndësishme për Kosovën. Komisioni duhet ta mbështes këtë projektligj dhe të debatohet në Kuvend, ku edhe ministri do të jep sqarime të mëtutjeshme se çka mund të bëhet dhe çfarë forme mund të gjejnë lidhur me fusnotën.

Puhie Demaku - Sa i përket fondit, në letër jemi anëtar të barabartë, por nëse marrëveshjet brenda fondit arrihen me konsensus, atëherë Serbia do të luftojë dhe pse ne mos ta luftojmë paraprakisht që të përfaqësohemi denjësisht. Me rastin e anëtarësimit në një forum ekzistues pranohen rregullat ekzistuese, ndërsa në këtë rast Kosova po pranon që në fillim të themelojë rregulla kundër vetës, duke u paraqit me fusnotë. Znj. Asnjë fond nuk është çmim që Kosova duhet paguar për heqje dorë nga subjektiviteti ndërkombëtar e shtetëror.

Blerta Deliu-Kodra -Një argument i rëndësishëm që të jemi pjesë e Fondit të Ballkanit Perëndimor është fakti se ky fond e ka qendrën në Republikën e Shqipërisë dhe udhëhiqet nga Shqipëria. Nëse vendimet në të gjithë mekanizmat rajonalë merren me konsensus, atëherë këtu shoh një gatishmëri të madhe të të gjitha shteteve të rajonit që ta ndihmojnë Kosovën që të jetë pjesë e projekteve që lidhen me edukimin, mjedisin, rininë dhe projekte të ndryshme ndërkufitare. Duhet të diskutohet për çështjen e fusnotës që është shqetësim, por nuk është interes i Kosovës që të përjashtohet nga këta mekanizma.

Zafir Berisha - Cilido fond apo mekanizëm ku Kosova nuk përfaqësohet si shtet, duhet të mendohet mirë para anëtarësimit. Do të votoj kundër dhe do të llojoj që kjo marrëveshje me gjithë të mirat që mund t'i ketë, por që simbolizon se Kosova nuk është e barabartë me vendet tjera, të mos kalojë.

Pal Lekaj - Meqë ministrat i kanë lëshuar takimet për shkak të fusnotës, atëherë pse të legjitimohet kjo në Kuvend. Me këtë, Kosova kthehet në kohën e UNMIK-ut, me rezolutën 1244.

Elmi Reçica -Janë duke ndodhë ndryshme rrënjësore si në Ballkan ashtu edhe në botë, është duke u rikthyer lufta e ftohtë dhe kjo është parë me rastin e trenit dhe me pozicionim tonë, të Serbisë dhe shteteve mike dhe kundërshtarë. Prej Rambujesë e tutje, sa i përket sa i përket diplomacisë, ne për herë të parë kemi krijuar aleanca dhe duhet t'i ruajmë ato.

Blerta Deliu Kodra - Për shkak të fusnotës ka pasur shumë deputetë e ministra që janë tërheqë nga takime të rëndësishme, por faza në të cilën po kalon Kosova si shtet duhet të ketë një vëmendje shumë të shtuar karshi proceseve integruese.

Ismet Beqiri - Ne përfaqësojmë subjekte të ndryshme politike dhe duhet ta shprehim mendimin tonë pa asnjë presion.

Pas diskutimeve të anëtarëve të Komisionit, kryetari konstatoi se Komisioni nxori këtë

P ë r f u n d i m

Miratohet Projektligji për ratifikimin e Marrëveshjes përkitazi me themelimin e Fondit të Ballkanit Perëndimor nr. 05/L-137, me shumicë votash.

6. Diskutim lidhur me kërkesën e deputetes znj. Puhie Demaku;

Elmi Reçica njoftoi se kjo pikë e rendit të ditës është radhitur në bazë të kërkesës së deputetes znj. Demaku, që në mbledhje të Komisionit të diskutohet për sjelljet e ambasadores Alma Lama, ndaj gazetarit të KTV.

Puhie Demaku - Reagimi ndaj rastit të ambasadores Alma Lama është i vonuar. Po ndodh një politizim i tejskajshëm i shërbimit të jashtëm të Republikës së Kosovës, dhe rezultatet e kësaj po shpërthejnë kohë pas kohe, siç ka ndodhë edhe ky i fundit nga ambasadorja Lama. Sjelljet e ambasadores Lama nuk janë befasi, ngase edhe me rastin e intervistës së saj ajo ka shpërfaqë një temperament të pakontrolluar, sjellje të pahijshme, të cilat nuk i përkohjnë karakterit të një ambasadori dhe një shpirt tepër idhnak.

Rastin e fundit të ambasadores Lama ndaj gazetarit z. Xhemajl Rexha e konsideroj tepër shqetësues, sepse çdo qëndrim i një ambasadori është qëndrim i MPJ-së dhe i Republikës së Kosovës, që për pasojë do duhej të kishim reagimin e menjëhershëm të MPJ-së dhe tërheqjen e saj nga detyra.

Lidhur me këtë rast propozoj që të kërkohet nga MPJ-ja të ndërmerr masa të menjëhershme për shkarkim të ambasadores Lama nga detyra dhe të ftohet ministri i MPJ-së për raportim në komision lidhur me shërbimin e jashtëm.

Zafir Berisha - Ambasadorja Lama përpos që nuk i ka plotësuar kriteret për të qenë ambasadore, ajo edhe në cilësinë e ambasadores mbanë qëndrime, të cilat nuk i bëjnë nderë diplomacisë. Kjo vije si rezultat se niveli diplomatik ka rënë veçanërisht në vitet e fundit. E përkrahi propozimin e deputetes Demaku që Komisioni të kërkojë në përputhje me ligjin në fuqi, që MPJ-ja të ndërmerr masa ndaj ambasadores Lama.

Elmi Reçica - Fyerjet nuk do të duhej të ishin prezentë veçanërisht tek personat publikë. Sa i përket kompetencave lidhur me shërbimin e jashtëm, si Komision e kemi vetëm një kompetencë, që t'i dëgjojmë kandidatët e propozuar për ambasadorë. Sa i përket emërimeve të ambasadorëve, ne jemi në pajtueshmëri me ligjin.

Me rastin e marrjes së detyrës, ata përfaqësojnë shtetin tonë. MPJ-ja e ka krijuar një komision disiplinor rreth rastit të ambasadores Lama dhe presim rezultatet e atij komisioni.

Rreth rastit të ambasadores Lama, pajtohem me propozimin që të ftohet ministri i MPJ-së për të raportuar në Komision lidhur me shërbimin e jashtëm dhe të kërkohet informatë me shkrim nga MPJ-ja lidhur me procedurën në këtë rast.

Ismet Beqiri - Në parim, si subjekt politik asnjëherë nuk përkrahim daljen jashtë kompetencave të kujt do qoftë, nga ato që janë të përcaktuara dhe duhet të kërkojmë nga të gjithë përfaqësuesit institucionalë që të sillemi ashtu siç duhet të sillemi në raport me të gjithë ata të cilët përcjellin punën tonë. Në rastin konkret MPJ-ja i ka rregullat e veta dhe çdo shërbyes duhet të punojë sipas rregullave dhe t'i zbatojë ato dhe të mos kemi praktika të tilla në të ardhmen.

Blerta Deliu Kodra - Dikur si gazetarë së bashku me Alma Lamën kemi dalë bashkërisht kundër gjuhës së urrejtjes dhe ndasive që ka pas nga shumë përfaqësues në vend, ndërsa ky rast është një lëshim i znj. Lama, i cili nuk duhet të përsëritet assesi. Ka rregulla e ligje, të cilat sanksionojnë veprimet dhe se qëndrimi i znj. Lama nuk përfaqëson qëndrimin e vendit. Në takimet e radhës me MPJ-në do të njoftohemi se deri ku kanë shkuar procedurat me këtë rast dhe bazuar në kompetencat tona të kërkojmë

që një gjuhë e tillë të mos përsëritet. Ka pasur edhe deklaratatë të këtilla të kolegëve tanë deputetë që nuk e kanë kursyer këtë gjuhë, por tani znj. Lama duhet ta kuptojë se ajo e përfaqëson shtetin e Kosovës dhe duhet të jetë e kujdesshme jo vetëm në raport me gazetarët, por edhe në raport me respektimin e pozicionit të saj të përfaqësueses së akredituar të shtetit të Kosovës
Pas diskutimeve të anëtarëve të Komisionit, kryetari konstatoi se Komisioni nxori këtë

P ë r f u n d i m

Lidhur me situatën e krijuar në mes të ambasadores Alma Lama me gazetarin e KTV-së, të kërkohet informatë me shkrim nga MPJ-ja, lidhur me veprimet e ndërmarra nga MPJ-ja, bazuar në rregullat e sjelljes së përfaqësuesve tanë jashtë vendit si dhe të ftohet ministri i MPJ-së të raportojë lidhur me Shërbimin Diplomatik të Republikës së Kosovës.

7. Informatë lidhur me organizimin e Samitit të kryetarëve të komisioneve të jashtme parlamentare;

Elmi Reçica njoftoi anëtarët e Komisionit për organizimin e Samitit të kryetarëve të jashtëm parlamentar nga Komisioni, lidhur me Ballkanin Perëndimor dhe integrimet euroatlantike, nga data 19 - 22 shkurt 2016. Ai tha se për organizimin e Samitit janë njoftuar Kryesia dhe Kryetari i Kuvendit dhe anëtarët e Komisionit dhe në vazhdimësi do të mbahen të informuar.

8. Të ndryshme.

Elmi Reçica- Çështja e ndalimit të z. Haradinaj ka hapur shumë çështje dhe si komision parlamentar duhet të kërkojmë sqarime dhe të angazhohemi që të dimë se çka është duke ndodhur me Interpolin dhe anëtarësimin e Kosovës në Interpol. Lidhur me këtë tha se ka idenë që të ftohen në raportim të gjithë resorët shtetërorë që janë të angazhuar në këtë proces dhe të shohim se çka mund të bëjmë si Komision parlamentar për ta lehtësuar këtë proces, për të cilin duhet të bëhet një itinerar se kënd duhet ta thërrasim.

Mbledhja përfundoi në orën 12:05.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i Komisionit

Kryetari i Komisionit

Elmi Reçica